



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KRYETARI

Nr. 2800 Prot.

Tiranë, më 07 . 10 .2025

U R D H Ë R

Nr.18, datë 7.10.2025

PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE, DATË 9.10.2025, ORA 10:00

Në mbështetje të nenit 7, pika 6, dhe nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin e punimeve për periudhën 29 shtator - 17 tetor 2025,

U R D H Ë R O J:

- I. Mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në datën 9.10.2025, ora 10:00.
- II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:
 1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 29.9.2025.
 2. Njoftime.
 3. Raporti i veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2024.
 4. Raport i veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) për vitin 2024.
 5. Raport i veprimtarisë vjetore të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për vitin 2024.
 6. Raport vjetor i veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2024.
 7. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.
- III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.
- IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Niko PELESHI





Legjislatura XI
Sesioni I

SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 9 tetor 2025, ora 10.00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrit nr.18, datë 7.10.2025 të Kryetarit të Kuvendit, Z. Niko Peleshi, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 29.9.2025.
(Neni 44, pika 2, të Rregullores së Kuvendit)
2. Njoftime
(Neni 44, pika 3, të Rregullores së Kuvendit)
3. **Raporti i veprimtarisë së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) për vitin 2024.**
(Neni 9 i ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe neni 8 i ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare”, 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës);
Paraqitja e raportit nga Kryetari i AKEP, z. Gentian Sala- jo më shumë se 20 minuta;
Lexohet projektrezoluta nga Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale;
Pyetje
Zhvillimi i debatit (Nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë)
Koha e votimit të projektrezolutës
4. **Raport i veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) për vitin 2024.**
(Neni 31 i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës);

Paraqitja e raportit nga Komisioneri, z. Besnik Dervishi - jo më shumë se 20 minuta;

Lexohet projektrezoluta nga Komisioni për Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik dhe Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale;

Pyetje

Zhvillimi i debatit (Nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë)

Koha e votimit të projektrezolutës

5. Raport i veprimtarisë vjetore të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për vitin 2024.

Neni 25, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, neni 21 pika 1 e ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" dhe neni 103 i Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës); Paraqitja e raportit nga Kryetari e ERE-s, z. Petrit Ahmeti - jo më shumë se 20 minuta;

Lexohet projektrezoluta nga Komisioni për Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale;

Pyetje

Zhvillimi i debatit (Nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë)

Koha e votimit të projektrezolutës

6. Raport vjetor i veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2024.

(Neni 103 pika 2 e Rregullores së Kuvendit dhe neni 31 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", shumicë e thjeshtë votash për miratimin e projektrezolutës)

Paraqitja e raportit nga Kryetarja e Komisionit Rregullator, znj. Gerta Lubonja - jo më shumë se 20 minuta.

Lexohet projektrezoluta nga Burimet Natyrore, Infrastrukturën dhe Zhvillimin e Qëndrueshëm dhe Komisioni për Nismat Qytetare, Bashkëpunimin dhe Mbikëqyrjen Institucionale;

Pyetje

Zhvillimi i debatit (Nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 10 deputetë)

Koha e votimit të projektrezolutës.

7. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)